

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVE –Departamenti për Krime te Rënda Gjyqtari Shaqir Zika, Kryetari i Trupit Gjykses, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Lamije Kuqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. G. nga fsh. B. K- Rahovec, për shkak të veprës penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 2 i KPRK-së, dhe të akuzuarit B. Sh. nga Rahoveci, për shkak të veprës penale, kanosje nga neni 185 par.2 lidhur me par 1 të KPRK-së, të akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore ne Gjakove, -Departamenti i Krimeve te Rënda, PP/I.nr.65/2016, datë 02.06.2016, në shqyrtimin fillestar gjyqësorë publik të mbajtur më datën 14.07.2016, me pjesëmarrjen e Prokurorit te Shtetit te PTH ne Gjakovë Agron Matjani, të akuzuarit A. G. dhe mbrojtësi i tij av. N. D., dhe i akuzuari B. Sh., murrë dhe të njëjtën ditë publikisht shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

1. I akuzuari: A. G., i lindur me ..., në fsh. B., K-Rahovec, nga i ati H. dhe ëma F., e lindur D., i martuar, i ati i dy fëmijëve, ka të kryer Fakultetin Ekonomik, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i R. së Kosovës.

2. I akuzuari: B. Sh., i lindur me ..., në Rahovec, nga i ati B. dhe ëma N., e lindur R., i pa martuar, nxënës i vitit të tretë i shkollës së mesme, i gjendjes se mesme ekonomike, Shqiptare, Shtetas. I R. Kosovës.

## ËSHTË FAJTOR

Për shkak së:

I akuzuari A. G., me datë 24.05.2016 rreth ores12:00, në Rahovec, në shkollën profesionale “Selajdin Mullabazi-Mici”, ka përdorur armën në mënyre frikësuese, në atë mënyre që pas një mosmarrëveshje që ka pasur paraprakisht me të dëmtuarin, nxënësin B. Sh., lidhur me ekskursionin e realizuar më herët në Germi dhe me datë 24.05.2016 i dëmtuari B. Sh. e ka thirrë profesorin për të biseduar në lidhje me mosmarrëveshjen që kanë pasur, i akuzuari A. ka dalur nga oborri i shkollës duke biseduar më pas dhe situata është tensionuar mes tyre, i akuzuari A. kthehet në shkollë, ka marrë armen, revolen EKO special 99, të kalibrit 9 mm, me nr. serik: 1422874 dhe të njëjtën armë e ka shkrepur.

- këso dore ka kryer vepër penale, përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 i KPRK-së.

I akuzuari B. Sh., me datë 24.05.2016 rreth ores12:00, në Rahovec, në shkollën profesionale “Selajdin Mullabazi-Mici”, seriozisht e ka kanosur të dëmtuarin A. G., në atë mënyre që pas një fjalosje në mes vete i akuzuari B. ka nxjerrë një brisk si mjet i

rrezikshëm dhe i përshtatshëm për të shkaktuar lëndime trupore serioze me të cilin i është kanosur të dëmtuari A., pasi që me herët kanë pasur mosmarrëveshje mes vete.

- këso dore ka kryer veprë penale, kanosje nga neni 185 par.2 lidhur me par 1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata me aplikimin e neneve 6.17, 41,46, 49, 50,51,52,62,73,75,76 para 1 pika 1.3, dhe neni 375 par.2 dhe neni 185 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe neneve 359 par. 2, të KPRK-se, të akuzuarit i gjykon me :

### DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarit të parë A. G., për veprë penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 2 i KPRK-së, e gjykon me dënim më burgim në kohëzgjatje prej 1 ( një ) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po së që i akuzuari në afate prej 2 ( dy ) viteve, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, po që se vjen deri të revokimi i dënimit me kusht në këtë dënim do të llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga dt. 24.05.2016, e gjere me dt. 24.06.2016, dhe dënimin më gjobe në shumë prej 1.500 (një mijë e pesëqind) €, i cili dënim do të paguhet në tri këste të barabarta pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast të mospagimit të dënimit me gjobë, i njëjti dënim do të zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 75(shtatëdhjetë e pesë) ditëve, duke llogaritur 1(një) ditë burgimi 20 (njëzet) Euro.

Të akuzuarit të dytë B. Sh., për veprën penale, kanosje nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, e gjykon dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 ( tre ) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet posë që i akuzuari në afate prej 1 (një) viti, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Të akuzuarit obligohen që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale, sa do të jënë sipas llogarisë së kësaj gjykate dhe në emër të paushallit gjyqësorë shumen me nga 50 (pesëdhjetë ) €, të gjitha këto në afate prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë,- Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP/I nr. 65/16 dt. 02.06.2016, kundër- të akuzuarit A. G. nga fsh. B., K-Rahovec, për shkak të veprës penale, përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 2 i KPRK-së dhe të akuzuarit B. Sh. nga Rahoveci, për shkak të veprës penal, kanosje nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestarë, me dt. 14.07.2016, ku prezent ka qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Agron Matjani, të akuzuarit A. G. se

bashku me av. N. D., i akuzuari B. Sh., dhe ka pasur kushte për mbajtjen e seancës së shqyrtimit fillestar.

Pas leximit të aktakuzës në seancën e shqyrtimit fillestar, Gjykata është bindur se të akuzuarit A. G. dhe B. Sh., kanë kuptuar aktakuzën, i është dhënë mundësia që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Me këtë rast Gjykata ka udhëzuar të akuzuarit për rendësin dhe pasojat e pranimit të fajësisë në kuptim në nenin 326 të KPPK-se, kështu që pas konsultimeve të bëra të akuzuarit me mbrojtësit e tyre kanë deklaruar se janë plotësisht të vetëdijshëm për rendësin e pranimit të fajësisë dhe ka shtuar se ky deklarim paraqet shprehje të vullnetit të tij të lire, pasi që janë kryes të kësaj veprave penale që akuzohen sipas aktakuzës, andaj në tërësi kanë pranuar fajësinë, i akuzuari i parë për dispozitivin I të aktakuzës ndërsa i akuzuari i dytë për dispozitivin II të aktakuzës, dhe se pranimi i fajësisë është i mbështetur në provat të cilat i janë ofruar Gjykatës në aktakuze dhe ata kallëzimi penale të DRP në Gjakovë, Njësitit i Hetimeve Rajonale në Gjakovë, me nr. 2016- EB-208, 2016-HRGJ-20, të dt. 24.05.2016, shqimi nga raporti i hetuesit, rreshterit Gëzim Biblekaj, deklaratat e të akuzuarve, vërtetimin e konfiskimit e gjësëndeve, revoles dhe briskut, si dhe shikimit e foto albumeve janë prova të mjaftueshëm dhe të besueshme që është mbështetur aktakuza.

Pas deklarimit të akuzuarve A. G., dhe B. Sh., për pranimin e fajësisë Kryetari i trupit gjykues kërkoj që mendimin e vet ta jep Prokurori i Shtetit.

Prokurori i Shtetit ka deklaruar se: pajtohet me deklarimin e të akuzuarve mbi pranimin e fajësisë dhe konsideron se një deklarim i tillë është plotësisht i vullnetshme nga ana e të akuzuarve dhe i njëjti mbështetet në prova që janë në shkresat e lëndës dhe i ka propozuar kryetarit të trupit Gjykues që të aprovoi pranimin e fajësisë të akuzuarve për vepra penale që ju vihen në barrë sipas aktakuzës, gjatë shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata të merr parasysh si rrethanë lehtësuese pranim e fajësisë, të njëjtit kanë qenë korrekt gjatë gjykimit, të njëjtit pas rastit me ndërmjetësim të familjarëve janë pajtuar dhe si provë kanë parashtruar deklaratën e noterizuar të noterit që këto dy familje janë pajtuar, andaj gjykata të ju shqiptoi një dënim të paraparë sipas ligjit.

Po ashtu i ka Propozuar Kryetarit të Trupit Gjykues që kundër të akuzuarve të ju shqiptohet dënimi plotësues, të akuzuarit të parë të ju konfiskohet pistoleta e markës EKO special 99, e kalibrit 9mm, me nr. serik: EU 1422874 dhe dy fishek të të njëjtit kalibër dhe të akuzuarit B. ti konfiskohet brisku, si mjet i kryerjes së veprës penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit të parë A. G., Av. N. D., ka deklaruar se nuk janë kontestuese faktet nga aktakuza, pasi që pranimi i fajësisë ka mbështetje në shkresat e lëndës ashtu siç pretendoi edhe Prokurori dhe në rastin konkret gjykatës i mbetet të përcaktohet lidhur me lartësinë e dënimit dhe unë i bashkëngjitem fjalës së Prokurorit që mund të jenë rrethana lehtësuese të karakterit personal të cilat tregojnë edhe një rrethanë tjetër shumë të rëndësishme që vepra është kryer aksidentalisht, pra nuk i parapriu asnjë motiv për kryerjen e kësaj veprë e kjo vërtetohet nga fakti se këtu të akuzuarit menjëherë pas rastit janë pajtuar mes vete e ky pajtim shpreh dhe keqardhjen e të dy palëve për rastin që ka ndodhur, andaj gjykata në rastin konkret ka mundësi ligjore që të shkoi në zbutje të jashtëzakonshme të dënimit nën minimumin e paraparë ligjor me të cilin dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit.

I akuzuari A. G., në tersi e ka mbështetur deklarinimin e mbrojtësit të tij, dhe njehe rit ka potencuar faktin se të njëjti janë pajtuar, ka shprehur keqardhjen për rastin dhe se ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale, dhe ai si palë e dëmtuar ndaj të akuzuarit B. Sh., nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore – juridike.

I akuzuari B. Sh., ka deklaruar se shpreh keqardhjen për rastin që ka ndodhur me të akuzuarin A. G., familja e tije dhe ai personalisht janë pajtuar me anë të burrave, andaj i propozoi gjykatës që të më shqiptoj një dënim sa më të bute dhe gjatë shqiptimit të dënimit të merr parasysh se unë kurrë nuk kamë qen i gjykuar dhe se unë e kam pranuar fajësinë dhe premtoj që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla po të ngjashme penale

Ne vijim, Gjykata duke shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarve vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje te vullnetit te lire te akuzuarve, pasi qe të njëjti kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, dhe pranimi i fajit është bere pas konsultimeve te nevojshëm me mbrojtësin e te akuzuarit të pare dhe shpjegimeve që ia bërë të akuzuarit të dytë nga Kryetari i Trupit Gjykses, dhe ky pranim mbështetet ne provat qe janë në aktakuzë konform nenit 326 te KPK-se.

Duke pasur parasysh Gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarve dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethane nga neni 248 te KPPK-se si dhe faktin se janë plotësuar kushtet nga neni 326 te KPPK-se e këtë qeshje penale nuk është zbatuar procedura e provave por gjykata shqyrtimin gjyqësor e ka vazhduar ne fjalën përfundimtare te palëve ne kuptim te nenit 352 te KPPK-se.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajit nga të akuzuarit të parë është vërtetuar gjendja faktike si ne dispozitivin I te këtij aktgjykimi, andaj ne veprimet e te akuzuarit A. G. ekzistojnë te gjitha tiparet e veprës penale, përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 2 të KPRK-së, ndërsa në veprimet e të akuzuarit të dytë B. Sh., të gjitha tiparet e veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, për te cilat vepra penale të akuzuarit janë penalisht përgjegjës dhe janë ndëshkuar si ne dispozitave te këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes se dënimit Gjykata i ka pasur parasysh te gjitha rrethanat nga neni 74 par 1 KPK-se, rregullin e përgjithshëm për zbutjen ose ashpërsimin e dënimeve dhe është e mundur që ti shqiptohet dënimi i kushtëzuar, nga se ekzistojnë kushte për zbutje te dënimit Gjykata ka gjetur posaçërisht rrethanat lehtësuese, i akuzuari i pare është mbajtës i familjes, i ati i dy fëmije, i dëmtuari rastin jua ka falur, më herët nuk ka qenë i gjykuar, andaj gjykata konform nenit 76 pika 1.3. te KPRK-se, ka zbutur dënimin nën minimumin e parapare Ligjore dhe te akuzuarit te pare i ka shqiptuar dënimin e kushtëzuar ne kohëzgjatje prej 1 ( një ) vite, me kusht për dy vite dhe dënim me gjobe, ne shume prej 1.500 (një mijë e pesëqind) €, ndërsa te akuzuarit te dyte si rrethanë lehtësues ka marrë parasysh pranimin e fajësisë, me të akuzuarin janë pajtuar, moshën e tije të re, andaj gjykata të njëjtit i ka shqiptuar dënimin e kushtëzuar me shprese dhe bindje se në dënimet e shqiptuara kundër të akuzuarve do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitat e nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe ne emër te paushallit gjyqësor bazohet ne dispozitat e nenit 450 par 3 të KPPK-se.

Nga arsyet e cekura me larte dhe me zbatimin e neni 365 par. 1 te KPPK-se është vendosur ne dispozitave te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË,  
PKR.nr 76/2016, dt.14.07.2016

Procesmbajtësja  
Lamije Kuqi

Kryetari i trupit gjykues  
Shaqir Zika

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund te parashtrohet ankesë, nëpër mjet kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit ne Prishtine ne afati prej 15 ditëve nga dita e pranimit te aktgjykimit.